



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 003
Prishtinë, më 3 mars 2011

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 3 MARS 2011**

Mbledhjen e kryesoi, **Jakup KRASNIQI** kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit.

Jakup KRASNIQI, në fillim të mbledhjes plenare shprehu indinjatën e thellë për aktin e ndodhur kriminal, më 2 mars 2011, në aeroportin e Frankfurtit, në Gjermani, me ç'rast një nënshtetas gjerman, me prejardhje nga Kosova, vrau dy ushtarë amerikanë dhe plagosi dy të tjerë.

Ai shprehu ngushëllimet më të thella për familjet e viktimave, Presidentin e SHBA-së, zotin Obama, popullin amerikan dhe Qeverinë Gjermane.

Në shenjë nderimi për dy viktimat, Kuvendi, me propozim të kryetarit, mbajti një minutë heshtje.

Ai i njoftoi deputetët se me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit dhe me Vendim të Presidentit të Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për ata deputetë që janë zgjedhur në Qeverinë e Kosovës. Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë: Amir Ahmeti, Hydajet Hyseni, Nijazi Idrizi, Suzan Novoberdaliu, Boban Todoroviq, Nait Hasani, Valbona Dibra, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Berat Buzhala, Kurtan Kajtazi, Fikrim Damka, Jeton Svirca, dhe Sasha Milosavljeviq.

Kryetari i ftoi deputetët e rinj të Kuvendit që të ngriten në këmbë për të dhënë betimin e deputetit. Kryetari lexoi tekstin e betimit, ndërsa ata në fund shqiptuan fjalën: **“betohemi”!**

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 21 dhe 22 shkurt 2011,
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqiti, në emër të GP të LDK-së, deputeti Sabri Hamiti, që është dhënë në Transkript.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 21 dhe 22 shkurt 2011

Ibrahim Makolli, kërkoi që transkripti i mbledhjes së mbajtur më 22 shkurt 2011, të korrigjohet në faqe 33, në pjesën ku thuhet se për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë votuar “për” 65 deputetë, të thuhet: “për” “64 deputetë”, përkatësisht që vota e presidentit të bëhet e pavlefshme. Ai kërkoi që e njëjta gjë të bëhet në faqen e 5-të të procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22 shkurt 2011.

Për këtë çështje diskutuan edhe deputeti Ardian Gjini dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, diskutime të cilat janë paraqitur në transkript.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e deputetit Ibrahim Makolli.

Kuvendi me shumicë votash nuk miratoi kërkesën e deputetit Ibrahim Makolli.

Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të 21 dhe 22 shkurtit 2011.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011

Kryetari njoftoi Kuvendin se Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraqitur Propozim – vendimin lidhur me zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, të

përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-218, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës Propozim – vendimin e arsyetoi ministri i Financave **Bedri Hamza**. Ministri Hamza tha se si pasojë e mos aprovimit të Ligjit të buxhetit për vitin 2011 në Kuvend i cili, siç dihet, për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe zgjatjes së tyre, nuk ka mund të bëhet deri më tani, si Qeveri i kemi propozuar Kuvendit që të miratojë zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011.

Ne si Qeveri nuk e kemi të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore për muajin mars 2011, pa miratimin nga Kuvendi i Kosovës të vendimit për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-218, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, tha ministri Hamza.

Ai po ashtu theksoi se miratimi i zgjatjes së ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, është me rëndësi të veçantë për organizatat buxhetore në vend.

Ai në fund shfaqti bindjen se gjatë muajit mars do të procedohet dhe miratohet në Kuvend Projekt-ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim – vendim dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjona, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Rashiq, emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, kryeministri Hashim Thaçi, si dhe deputeti Arben Gashi, që janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-218 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 114,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet zgjatja e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011, të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-218, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.
2. Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit.

Në fund të mbledhjes, kryeministri Hashim Thaçi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me bisedimet e ardhshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Për bisedimet e ardhshme fjalën e fundit do ta ketë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11 : 50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale